

# **IKAF AC-P2 Raportimi i Korporatave**

## **Syllabus dhe Udhëzues Studimi**

*Kualifikimi Auditor i Jashtëm i Certifikuar*  
(Bazuar në Certifikimet ACCA)

Ky planprogram dhe udhëzuesi i studimit është i dizajnuar për të ndihmuar në mësimdhënie dhe mësimnxënie, dhe ka për qëllim të ofrojë informata të hollësishme në lidhje me kualifikimin, modulën dhe udhëzuesin e studimit.

### **Struktura e Kualifikimit**

Shpjegon përmbajtjen e kualifikimit të nivelit Auditor i Jashtëm i Certifikuar në të cilën bënë pjesë edhe moduli Raportimi i Korporatave. Ndërlidhja e këtij moduli me nivelet dhe modulet tjera të kualifikimit. Modulet e përfshira në nivelin e caktuar si dhe kriteret për antarësim; si dhe karakteristikat e ligjeratave të cilat mbahen gjatë periudhës së certifikimit. Modulet dhe Kualifikimi janë paraqitur edhe me anë të diagramit.

### **Moduli**

Shpjegon shkurtimisht arsyetimin e rëndësisë së modulit, objektivat e përgjithshme dhe të detajuara të modulit dhe tregojnë në kuptimin më të gjerë aftësitë që do të zhvillohen gjatë studimit të modulit në fjalë. Ndërlidhja e modulit me modulet tjera të caktuara paraqitet me anë të një diagrami, që paraqesin lidhjet ndërmjet tyre; me qëllim që të jetë sa më e qartë për lexuesin. Poashtu përshkruhen dhe temat që i përkasin modulit; se si është planifikuar moduli me tema dhe nëntema. Gjithashtu, shpjegohen edhe forma e ekzaminimit dhe vlerësimit, në detaje se çfarë do të shqyrtojnë provimi dhe pse. Në fund krejt është bashkangjitur shtojca e përmbajtjes së modulit.

### **Struktura e Syllabusit**

Shpjegon përmbajtjen e syllabusit të modulit Raportimi i Korporatave i cili është pjesë e nivelit Auditor i Jashtëm i Certifikuar. Ky modul përmban arsyetimin, qëllimin dhe aftësitë kryesore që pritet të fitohen gjatë kohës së studimit. Veç kësaj syllabusi përfshinë edhe temat e modulit në fjalë, strukturën e ekzaminimit pas përfundimit me sukses të modulit si dhe të lexuarit dhe planifikimin e kohës.

### **Udhëzuesi i Studimit**

Ky është seksioni kryesor i të dhënave që nxënësit dhe mësimdhënësit duhet ta përdorin si bazë të studimeve, mësimve dhe materialeve të tyre përkatësisht. Provimet do të bazohen në detajet e udhëzuesit të studimit i cili identifikon në mënyrë gjithëpërfshirëse se çfarë mund të vlerësohet në çdo seancë provuese. Udhëzuesi i studimit është i ndarë në seksione të bazuara në aftësitë kryesore të identifikuar në programin mësimor. Këto seksione ndahen në fusha të lëndëve që lidhen me nën-aftësitë e përfshira në planprogramin e detajuar. Fushat e lëndëve ndahen në nëntituj që përshkruajnë rezultatet e detajuara që mund të vlerësohen në provime.


## STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

*Kualifikimi Auditor i Jashtëm i Certifikuar  
(Bazuar në Certifikimet ACCA)*

Auditori i Certifikuar fillimisht duhet të kualifikohet si Kontabilist i Certifikuar në IKAF. Jo për të gjithë Kontabilistët e Certifikuar kërkohet ose është e nevojshme të kualifikohen Auditor të Certifikuar, me përjashtim të rastit nëse ata zgjedhin një karrierë në ofrimin e auditimeve ligjore dhe shërbimeve përkatëse. Këshilli Kosovar për Raportim Financiar (KKRF) licencon Auditorët në Kosovë dhe roli i IKAF-it është për të siguruar se ata janë të certifikuar në përputhje me standardet Ndërkombëtare të Edukimit, Direktivën e 8 të BE-së dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Në vitet e fundit standardet e edukimit dhe kërkesat e praktikës profesionale për Auditorët Ligjor janë përditësuar, andaj skema e re e kualifikimit në IKAF ka për qëllim të sigurojë që auditorët e Kosovës janë të kualifikuar me standardet më të larta ndërkombëtare.

Për të u trajnuar për kualifikim si Auditor i Certifikuar, ju së pari duhet të jeni anëtar i IKAF dhe të keni përfunduar kualifikimin për Kontabilist të Certifikuar. Anëtarësia në këtë nivel është e hapur për të gjithë profesionistët që punojnë në kontabilitet dhe auditim dhe të cilët kanë përfunduar nivelin për Kontabilist të Certifikuar.


Kandidatët në Kualifikimin për Auditor i Jashtëm i Certifikuar duhet të demonstrojnë njohuri të veçanta edhe në modulën “Raportimi i Korporatave”.



Diagrami.1.: Nderlidhjet e moduleve dhe certifikimeve deri tek titulli Auditor i Jashtëm i Certifikuar

## Modulet

Kualifikimi Auditor i Jashtëm i Certifikuar përmbanë gjithsej pesë module të cilat duhet të studiohen dhe të përfundojnë me sukses; me qëllim të fitimit të titullit.



Diagrami.2.: Modulet e Kualifikimit Auditor i Jashtëm i Certifikuar

### **KRITERET E KUALIFIKIMIT DHE ANETARESIMIT: Auditor i Jashtëm i Certifikuar**

- Diplomë Universitare;
- Përfundimin e nivelit për Kontabilistë të Certifikuar;
- Dëshmi mbi përvojën e punës 3 vite në auditim apo kontabilitet;..
- Të kenë vijuar dhe kaluar pesë (5) provimet e certifikimit për këtë qëllim (Provimi quhet i dhene nese arrihet 50% e pikeve ne test).
- Personi që është i certifikuar në këtë kualifikim nga IKAF dhe vazhdon të jetë anëtar me status të rregullt pranë IKAF-it, ka të drejtë të përdor titullin “Auditori i Certifikuar” duke plotësuar gjitha kriteret e mesiperme.
- Antaret e rregullt ne IKAF për ta përdor titullin “Auditori i Certifikuar” e kane obligative ndjeken e edukimit te vazhdueshem professional (EVP/CPD) te percaktuara edhe ne rregullore

### **Karakteristikat e ligjerates trajnuese:**

- Rishikimi i përgjithshëm i moduleve, dhe gjatë ligjerates, studentët do të jenë të pajisur me raste të studimit, shembujve të ngjashëm nga ato që trajtohen të testet ACCA, dhe shmebuj të provimeve.
- Ligjeresit mbajnë kualifikime profesionale si dhe eksperience pune në fushen e caktuar të ligjerimit.
- Planprogrami trjanues është i bazuar në planëprogramet ACCA.
- Në përfundim të kësaj ligjerate, studentet do të jenë te gatshëm ti nënshtrohen provimit në qendren e Institutit KAF.

# **STRUKTURA E SYLLABUSIT**

## **Arsyetimi**

Shpjegon se si është strukturuar programi dhe si janë të ndërlidhura aftësitë kryesore. Arsyetimi gjithashtu shpjegon në detaje se çfarë do të përmbajë ekzaminimi dhe pse.

## **Diagrami i relacioneve mes moduleve**

Ky diagram tregon lidhjet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta midis këtij moduli dhe moduleve të tjera që i paraprijnë ose pasojnë. Ai tregon se ku ju pritët të keni njohuri themelore dhe ku do të ishte e dobishme të rishikoni të mësuarit e mëparshëm përpara se të filloni studimin.

## **Qëllimi**

Kjo shpjegon shkurtimisht objektivin e përgjithshëm të planprogramit dhe tregon në kuptimin më të gjerë aftësitë që duhet të zhvillohen brenda studimit të modulit.

## **Aftësitë kryesore**

Qëllimi i planit mësimor është i ndarë në disa funksione kryesore që ndajnë programin mësimor dhe udhëzuesin studimor në seksione diskrete.

## **Temat**

Temat e caktuara që i përmbanë moduli dhe që do të trajtohen gjatë studimit dhe ligjerimit.

## **Struktura e Ekzaminimit**

Ky seksion shpjegon shkurtimisht strukturën e ekzaminimit dhe si bëhet vlerësimi.

## **Shtojcë Syllabusi i Detajuar**

Kjo tregon ndarjen temave dhe nëntemave kryesore të planprogramit në fushat e lëndëve. Ky është pilotprojekt për manualin e detajuar të studimit.

# MODULI

## Arsyetime

Plan programi për Provimin P2 Raportimi i Korporatave, kërkon njohuritë e përvetësuar në nivelin themelor përfshirë aftësitë kryesore teknike për përgatitjen dhe analizimin e raporteve financiare për njësi ekonomike të vetme dhe të kombinuara.



Diagrami.1.: Ndërlidhja e Moduleve

Plan programi i provimit P2 e shqyrton lëndën më thellë dhe vendos në kontekst rolin e kontabilistit si shërbyes profesional dhe këshillues / analist, duke eksploruar fillimisht detyrat profesionale në përgjithësi dhe përgjegjësitë e kontabilistit ndaj palëve të interesuara dhe organizatës.

Plan programi vlerëson kornizën mbi raportimin financiar brenda të cilës vepron kontabilisti dhe vlerëson kërkesat e detajuara të raportimit financiar për njësitë ekonomike duke çuar drejt përgatitjes së raporteve financiare për grupin në pajtim me praktikat kontabël të pranuar përgjithësisht dhe standardet përkatëse. Plan programi pastaj vazhdon me natyrën e raportimit për njësi ekonomike të specializuara përfshirë njësitë ekonomike jo fitimprurëse dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

Pjesët e fundit të plan programit eksplorojnë - më në detaje - rolin e kontabilistit si analist dhe këshillues financiar përmes vlerësimit të performances dhe pozicionit financiar të njësive ekonomike dhe rolin e kontabilistit në vlerësimin dhe këshillimin mbi implikimet e rregulloreve të kontabilitetit mbi raportimin e korporatave. Në fund, plan-programi mbulon vlerësimin e zhvillimeve të fundit dhe implikimet e tyre në raportimin financiar.

## Qëllimi

Aplikimi i njohurive, aftësive dhe ushtrimi i gjykimit profesional në aplikimin dhe vlerësimin e parimeve dhe praktikave të raportimit financiar në disa kontekste dhe situata biznesore.

## Aftësitë kryesore

- Diskutimi i detyrave profesionale dhe etike të kontabilitetit
- Vlerësimi i kornizës për raportim financiar
- Këshillimi dhe raportimi mbi performancën financiare të njësive ekonomike

- Përgaditja e pasyqrave financiare të grupeve të njesive ekonomike në pajtim me standardet përkatëse të kontabilitetit
- Shpjegimi i çështjeve të raportimit që lidhen me njësitë ekonomike të specializuara
- Diskutimi i implikimeve të ndryshimeve në rregulloret e kontabilitetit mbi raportimin financiar
- Vlerësimi i performancës dhe pozicionit financiar të njesive ekonomike
- Vlerësimi i zhvillimeve të fundit

## Temat

Temat kryesore të Modullit Raportimi i Korporatave që do të trajtohen gjatë ligjerates:

Detyrat Profesionale dhe Etike të Kontabilistit
Korniza mbi Raportimin Financiar
Raportimi i Performancës Financiare të Njesive Ekonomike
Pasyqrat Financiare të Grupeve të Njesive Ekonomike
Njësitë Ekonomike të Specializuara
Implikimet e Ndryshimeve në Rregulloret Kontabël mbi Raportimin Financiar
Vlerësimi i Performancës dhe Pozicionit Financiar të Njësitë Ekonomike
Zhvillimet e fundit

Diagrami.2.: Temat që do të trajtohen në Modulin Raportimi i Korporatave

## Struktura e Ekzaminimit

Provimi mbahet në formë të shkruar dhe përmban pyetje nga të gjitha pjesët e tekstit. Testi do të ketë pyetje të hapura të cilat gjenden në kuadër të këtij teksti. Përgjigjet mund të nxirren nga leximi i tekstit dhe nga ligjëratat e mbajtura. Disa prej pyetjeve mund të kërkojnë përgjigje teorike, kurse pjesa më e madhe e tyre do të jenë pyetje të kombinuara dhe përgjigja jepet në kuadër të alternativave të dhëna në test.

## Të lexuarit dhe planifikimi i kohës

Për 3 orët e provimit, janë konsideruar 15 minuta kohë për lexim dhe planifikim.

Kjo kohë shtesë është e lejuar në fillim të cdo provimi tre orësh për të lejuar kandidatët t'i lexojnë pyetjet dhe përgjigjet për të filluar planifikimin e tyre para se të fillojnë të shkruajnë përgjigjet. Kjo kohë duhet të përdoret për të siguruar që të gjitha informatat e kërkuara dhe provimi janë lexuar dhe kuptuar si duhet.

Shtojcë: Syllabusi i Detajuar

# Syllabusi i Detajuar

## A Detyrat profesionale dhe etike të kontabilistit

1. Sjellja profesionale dhe pajtueshmëria me standardet e kontabilitetit
2. Kërkesat etike mbi raportimin për korporata dhe pasojat e sjelljes jo etike
3. Përgjegjësia sociale

## B Korniza mbi raportimin financiar

1. Aplikimet, përparësitë dhe të metat e kornizës së kontabilitetit
2. Vlerësimi kritik i parimeve dhe praktikave

## C Raportimi performances financiare të njësive ekonomike

1. Raportimi i performances
2. Pasuritë jo qarkulluese
3. Instrumente financiare
4. Qiratë
5. Segmenti që raporton
6. Përfitimet e punonjësve
7. Tatimet mbi te ardhurat
8. Provizionet, kushtëzimet dhe ngjarjet pas datës së raportimit
9. Palët e lidhura
10. Pagesa bazuar në aksione
11. Kërkesat për raportimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM)

## D Pasqyrat financiare të grupeve të njësive ekonomike

1. Kontabilizimi për grupet përfshirë pasqyrën e rrjedhjes së parasë
2. Interesat e vazhdueshëm dhe jo të vazhdueshëm
3. Ndryshimet në strukturat e grupit
4. Transaksionet e huaja dhe njësitë ekonomike

## E Njësitë ekonomike të specializuara

1. aportimi financiar për njësitë ekonomike të specializuara, jo fitimprurëse dhe të sektorit publik
2. Reformimet e njësisë ekonomike

## F Implikimet e ndryshimeve në rregulloret kontabël mbi raportimin financiar

1. Efekti i ndryshimeve në standardet kontabël në sistemet kontabël
2. Ndryshimet e propozuara për standardet kontabël

## G Vlerësimi i performances dhe pozicionit financiar të njësisë ekonomike

1. Krijimi i politikave të duhura kontabël
2. Analizimi dhe interpretimi i informatave financiare dhe matja e performances

## **H Zhvillimet e fundit**

1. Raportimi social dhe mjedisor

2. Konvergjenca mes standardeve raportuese kombëtare dhe ndërkombëtare

3. Çështjet e tanishme të raportimit



## **Udhëzues Studimi**

### **A DETYRAT ETIKE DHE PROFESIONALE TË KONTABILISTIT**

#### **1. Sjellja profesionale dhe pajtueshmëria me standardet kontabël**

- a) Vlerësoni dhe diskutoni çështjet etike dhe profesionale në këshillimin mbi raportimin e korporatave. [3]
- b) Vlerësoni ndërlidhjen dhe rëndësinë e çështjeve etike dhe profesionale për pajtueshmërinë me standardet kontabël. [3]

#### **2. Kërkesat etike për raportimin e korporatës dhe pasojat e sjelljes jo-etike**

- a) Vlerësoni implikimet potenciale etike të vendimeve profesionale dhe menaxheriale gjatë përgatitjes së raporteve të korporatës.
- b) Vlerësoni pasojat e mos respektimit të parimeve etike gjatë përgatitjes së raporteve të korporatës. [3]

#### **3. Përgjegjësia sociale**

- a) Diskutoni kërkesën e rritur për transparencë në raportet e korporatës dhe emergjencën e standardeve raportuese jo financiare. [3]
- b) Diskutoni përparimin drejt një kornize për raportim mjedisor dhe raportim mbi qëndrueshmërinë. [3]

### **B KORNIZA MBI RAPORTIMIN FINANCIAR**

#### **1. Aplikimet, përparësitë dhe të metat e kornizës kontabël**

- a) Vlerësoni modelet e vlerësimit të adoptuara nga standard-vënësit. [3]
- b) Diskutoni përdorimin e kornizës së kontabilitetit në përfundim të nxjerrjes së standardeve kontabël. [3]
- c) Vlerësoni suksesin kornizës së tillë në paraqitjen e standardeve kontabël rigoroze dhe të qëndrueshme. [3]

#### **2. Vlerësimi praktik i parimeve dhe praktikave**

- a) Identifikoni raportin mes teorisë së kontabilitetit dhe praktikës së kontabilitetit.
- b) Në mënyrë kritike vlerësoni parimet kontabël dhe praktikatat e përdorura në raportimin e korporatave. [3]

### **C RAPORTIMI I PERFORMANCES FINANCIARE TË NJËSIVE EKONOMIKE**

#### **1. Raportimi i performances**

- a) Përgatisni raportet që lidhen me korporata të performances për palët e jashtme.
- b) Diskutoni çështjet që lidhen me njohjen e të hyrave. [3]
- c) Vlerësoni ndryshimet e propozuara për raportimin e performances financiare.

#### **2. Pasuritë jo qarkulluese**

- a) Aplikoni dhe diskutoni kohën e njohjes së pasurive jo qarkulluese dhe përcaktimin e vlerave të tyre bartëse përfshirë çvlerësimet dhe rivlerësimet. [3]
- b) Aplikoni dhe diskutoni trajtimin e pasurive jo qarkulluese të mbajtura për shitje. [3]
- c) Aplikoni dhe diskutoni trajtimin kontabël për pasuri afatgjate materiale të investuara përfshirë klasifikimin, njohjen dhe matjen. [3]
- d) Aplikoni dhe diskutoni trajtimin kontabël të pasurive të paprekshme përfshirë kriteret e

njohjes dhe matjes si pasojë e blerjes dhe klasifikimit. [3]

### **3. Instrumentet financiare**

- a) Aplikoni dhe diskutoni njohjen dhe mos njohjen (largimin nga pasqyrat) e pasurive financiare dhe detyrimeve financiare. [2]
- b) Aplikoni dhe diskutoni klasifikimin e pasurive financiare dhe detyrimeve financiare dhe matjen e tyre. [2]
- c) Aplikoni dhe diskutoni trajtimin e fitimeve dhe humbjeve nga pasuritë dhe detyrimet financiare. [2]
- d) Aplikoni dhe diskutoni trajtimin e çvlerësimit të pasurive financiare. [2]
- e) Kontabilizoni instrumentet financiare derivative dhe derivativet e përfshirë të thjeshtë. [2]
- f) Paraqitni parimet e kontabilitetit të mbrojtjes për mbrojtje në vlerë të drejtë dhe mbrojtjen e rrjedhjes së pasasë përfshirë efektin e mbrojtjes. [2]

### **4. Qiratë**

- a) Aplikoni dhe diskutoni klasifikimin e qirasë dhe kontabilizimin për qiratë nga qiramarrësi dhe qiradhënësi. [3]
- b) Kontabilizoni dhe diskutoni transaksionet e shitjes dhe rimarrjes me qira. [3]

### **5. Segmenti që raporton**

- a) Përcaktoni natyrën dhe masën e segmenteve raportuese. [3]
- b) Specifikoni dhe diskutoni natyrën e informatave të segmentit që duhet të shpalosen. [3]

### **6. Përfitimet e punonjësve**

- a) Aplikoni dhe diskutoni trajtimin kontabël të përfitimeve afat gjatë dhe afat shkurtër të punonjësve. [3]

- b) Aplikoni dhe diskutoni trajtimin kontabël të kontributeve të definuara dhe planeve të definuara të përfitimeve. [3]
- c) Kontabilizoni humbjet dhe fitimet nga marrëveshjet dhe shkurtimet. [2]
- d) Kontabilizoni testin e “lartësisë maksimale të pasurive- asset ceiling (ang)” dhe raportimin e fitimeve apo humbjeve aktuariale. [2]

### **7. Tatimet mbi të ardhurat**

- a) Aplikoni dhe diskutoni njohjen dhe matjen e detyrimeve tatimore të shtyra dhe pasurive tatimore të shtyra. [3]
- b) Përcaktoni njohjen e shpenzimeve apo të hyrave tatimore dhe përfshirjen e tyre në pasqyrat financiare. [3]

### **8. Provizionet, kushtëzimet dhe ngjarjet pas datës së raportimit**

- a) Aplikoni dhe diskutoni njohjen, mosnjohjen dhe matjen e provizioneve, pasurive dhe detyrimeve të kushtëzuara përfshirë provizionet mjedisore. [3]
- b) Llogarisni dhe diskutoni ristrukturimin e provizioneve. [3]
- c) Aplikoni dhe diskutoni mbi ngjarjet pas datës së raportimit. [3]
- d) Përcaktoni dhe raportoni çështjet e vijimësisë që dalin në pah pas datës së raportimit. [3]

### **9. Palët e lidhura**

- a) Përcaktoni palët që konsiderohen si palë të lidhura për një njësi ekonomike. [3]
- b) Identifikoni implikimet e marrëdhënieve të palëve të lidhura dhe kërkesat për shpalosje. [3]

### **10. Paguesa bazuar në aksione**

- a) Aplikoni dhe diskutoni njohjen dhe kriteret për matjen e transaksioneve të pagesave bazuar në aksione. [3]
- b) Kontabilizoni modifikimet, anulimet dhe zgjidhjet e transaksioneve të pagesave bazuar në aksione. [2]

### **11. Kërkesat për raportimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM)**

- a) Paraqisni pikëpamjet kryesore në zhvillimin e një grupi standardesh kontabël për NVM. [3]
- b) Diskutoni zgjidhjet mbi problemin e raportimit financiar diferencial. [3]
- c) Diskutoni arsyet pse SNRF për NVM nuk i adresojnë disa çështje.
- d) Diskutoni trajtimin kontabël që nuk lejohet sipas SNRF për NVM përfshirë modelin e rivlerësimit për pasuri të caktuara. [3]
- e) Diskutoni dhe aplikoni thjeshtësimet e paraqitura nga SNRF për NVM përfshirë kontabilizimin për goodwill dhe pasuri të paprekshme, instrumente financiare, skemat përfituese të definuara, diferencat këmbimore dhe pjesëmarrjet dhe sipërmarrjet.

### **D PASQYRAT FINANCIARE PËR NJËSITË EKONOMIKE TË GRUPEVE**

#### **1. Kontabilizimi për grupin përfshirë pasqyrat e rrjedhjes së parasë**

- a) Aplikoni metodën e kontabilizimit për kombinimet biznesore përfshirë strukturat komplekse të grupit.
- b) Aplikoni parimet për përcaktimin e kostos së kombinimit biznesor. [3]
- c) Aplikoni kriterin e njohjes dhe matjes për pasuritë dhe detyrimet e identifikueshme të blera dhe goodwill-in përfshirë blerjet në shkallë. [3]

- d) Aplikoni dhe diskutoni kriteret e përdorura për të identifikuar një filiale dhe një pjesëmarrje. [3]
- e) Përcaktoni dhe aplikoni procedurat përkatëse që duhet të përdoret gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare të grupit. [3]
- f) Identifikoni dhe paraqisni: - rrethanat në të cilat nga grupi kërkohet të përgatisë pasqyra financiare të konsoliduara. - rrethanat kur grupi mund të kërkojë dhe të bëjë përjashtim nga përgatitja e pasqyrave financiare të konsoliduara. [2] - pse drejtuesit mund të mos duan ta konsolidojnë filialën dhe kur një gjë e tillë lejohet. [2]
- g) Aplikoni metodën kontabël të ekuitetit për pjesëmarrjet. [3]
- h) Paraqisni dhe aplikoni përkufizimet kryesore dhe metodat kontabël që lidhen me interesat në marrëveshjet e përbashkëta. [3]
- i) Përgatisni dhe diskutoni pasqyrat e rrjedhjes së parasë për grupin. [3]

#### **2. Interesat e vazhdueshme dhe jo të vazhdueshme**

- a) Përgatisni pasqyrat financiare të grupit ku aktivitetet janë ndërpresë apo janë blerë apo shitur gjatë periudhës. [3]
- b) Aplikoni dhe diskutoni trajtimin e filiales e cila është blerë ekskluzivisht për tu shitur më pas. [3]

#### **3. Ndryshimet në strukturat e grupit**

- a) Diskutoni arsyet pas riorganizimit të grupit. [3]
- b) Vlerësoni dhe çmoni kushtet kryesore të një riorganizimi të propozuar të grupit. [3]

#### **2. Ndryshimet e propozuara në standardet kontabël**

- a) Identifikoni çështjet dhe mungesat që kanë sjellë te propozimi për ndryshimin e standardeve të kontabilitetit. [2]

## **G VLERËSIMI I PERFORMANCES DHE POZICIONIT FINANCIAR TË NJËSISË EKONOMIKE**

### **1. Krijimi i politikave kontabël të përshtatshme**

- a) Zhvilloni politika kontabël për një njësi ekonomike e cila i përmbush kërkesat për raportim. [3]
- b) Identifikoni trajtimet kontabël të adoptuara në pasqyrat financiare dhe vlerësoni përshtatshmërinë dhe pajtueshmërinë e tyre. [3]

### **2. Analiza dhe interpretimi i informatave financiare dhe matja e performances**

- a) Përzgjidhni dhe llogarisni treguesit relevant të performances financiare dhe jo financiare.

### **4. Transaksionet e huaja dhe njësitë ekonomike**

- a) Paraqisni dhe aplikoni përkthimin e shumave në valutë të huaj dhe transaksionet në valutë funksionale si dhe valutën prezantuese. [3]
- b) Kontabilizoni konsolidimin e operacioneve të huaja dhe shitjen e tyre. [2]

## **E NJËSITË EKONOMIKE TË SPECIALIZUARA DHE TRANSAKSIONET E SPECIALIZUARA**

### **1. Raportimi financiar në njësitë ekonomike të specializuara, jo fitimprurëse dhe të sektorit publik**

- a) Aplikoni njohuritë e përfituara nga plan programi për t'iu qasur transaksioneve dhe ngjarjeve në njësitë ekonomike të specializuara, jo fitimprurëse dhe të sektorit publik.

### **2. Riorganizimet e njësisë ekonomike**

- a) Identifikoni kur një njësi ekonomike nuk mund të shikohet më si e vijueshme apo ekziston pasiguri rreth statusit të vijueshmërisë së saj. [2]
- b) Identifikoni dhe paraqisni rrethanat në të cilat riorganizimi do të ishte alternativa më e mirë për likuidimin e kompanisë. [2]
- c) Paraqisni trajtimin e duhur kontabël që kërkohet për riorganizimin e njësisë ekonomike. [2]

## **F IMPLIKIMET E NDRYSHIMEVE NË RREGULLORET E KONTABILITETIT MBI RAPORTIMIN FINANCIAR**

### **1. Efekti i ndryshimeve në standardet e kontabilitetit në sistemet e kontabilitetit**

- a) Aplikoni dhe diskutoni implikimet kontabël nga adoptimi për herë të parë të një standardi të ri të kontabilitetit. [3]
- b) Identifikoni dhe vlerësoni karakteristikat dhe çështjet kryesore në pasqyrat financiare.
- c) Theksoni jo-konsistencën në informata financiare përmes analizimit dhe aplikimit të njohurive.
- d) Nxirrni konkluzione nga analiza e informatave duke marrë parasysh kufizimet në informata, metodat analitike të përdorura dhe mjedisin biznesor në të cilin operon njësi ekonomike.

## **H ZHVILLIMET E FUNDIT**

### **1. Raportimi social dhe mjedisor**

- a) Vlerësoni ndikimin e faktorëve mjedisor, social dhe etik në matjen e performances. [3]
- b) Vlerësoni kërkesat e tanishme raportuese në fushën e caktuar. [3]
- c) Diskutoni pse njësitë ekonomike mund të përfshijnë shpalosje që kanë të bëjnë me mjedisin dhe shoqërinë.

## **2. Konvergjenca mes standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të raportimit**

- a) Vlerësoni implikimet e konvergjencës mbarë botërore me Standardet ndërkombëtare të raportimit financiar.
- b) Diskutoni ndikimin e rregullatorëve kombëtar në raportimin financiar ndërkombëtar. [2]

## **3. Çështjet e tanishme të raportimit**

- a) Diskutoni çështjet e tanishme në raportimin e korporatave.